



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
Shoqëria Përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK  
NIPT L22412014N  
Licencë LN-5977-12-2012

Nr. 214/4 Prot.  
Nr. 214 Regj.

Datë 05.12.2018

**URDHËR**  
**PËR VËNIEN E SEKUESTROS**

**Drejtuar:** Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë

**Për dijëni Debitorit:** Shoqëria "TV-Blu" SHPK, me NIPT K83617801A, me zyrë qendrore në: Rruga "Qemal Stafa", ndërtese 5 katëshe, Golem, Kavaj.

**Për dijëni Kreditorit:** Autoriteti i Mediave Audiovizive, me adresë në rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Tiranë.

Pranë shoqërisë përmbareuese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK, sipas kërkesës Nr. 4045/1 Prot., datë 22.10.2018, të kreditorit Autoriteti i Mediave Audiovizive, është regjistruar çështja përmbareuese me nr. 214 Regj, datë 24.10.2018 me palë:

**Kreditor:** Autoriteti i Mediave Audiovizive  
**Debitor:** Shoqëria "TV-Blu" SHPK  
**Objekti:** Vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendim Nr. 58, datë 19.03.2018 të AMA-s, për të cilin është dhënë vendimi nr. Regj. Them. 1110, datë 14.06.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Unë përmbareuese gjyqësore private Fatjona Duka, pasi u njoha me aktet e dosjes përmbareuese:

**KONSTATOVA**

Se, kreditori Autoriteti i Mediave Audiovizive me vendimin nr. 58, datë 19.03.2018 ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit debitor, Shoqëria "TV-Blu" SHPK, si dhe ka bërë një përlllogaritje të detyrimeve financiare për këtë subjekt. Vendimi i sipërcituar i është njoftuar debitorit me shkresën nr. 1511 Prot., datë 03.04.2018. Debitori edhe pse ka pasur dijëni për këtë vendim dhe detyrimin e tij nga kreditorit Autoritetit të Mediave Audiovizive, nuk ka paguar vullnetarisht detyrimet financiare.

Në këto kreditori Autoriteti i Mediave Audiovizive i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv vendim nr. 58, datë 19.03.2018, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve në shumën 54,768 (pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, me vendimin nr. Regj. Them. 1110 (31134-03679-80-2018), datë 14.06.2018, "Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit", ka vendosur:

"- Pranimin e kërkesës.

- Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 58, datë 19.03.2018 në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare nga ana e shoqërisë "TV-BLU" shpk kundrejt AMA-s, vetëm për masën prej 54,768 (pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

Me anë të kërkesës drejtuar shoqërisë përbaruese "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK, kreditori AMA ka kërkuar vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendim Nr. 58, datë 19.03.2018 të AMA-s, për të cilin është dhënë vendimi "Urdhër ekzekutimi" nr. Regj. Them. 1110 (31134-03679-80-2018), datë 14.06.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në kushtet kur debitori nuk ka paguar detyrimin ndaj kreditorit, në shumën 54,768 (pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, pavarësisht dijenisë së tij për këtë detyrim, debitori do të paguajë dhe kamatëvonesat ligjore për mospagimin në afat të këtij detyrimi. Me qëllim llogaritjen e këtyre kamatave do të caktohet një ekspert dhe do t'ju komunikohet vlera e këtyre kamatave

Në këto kushte në bazë të nenit 519, 527 të K.Pr.Civile. vendosa të filloj procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm të titullin ekzekutiv për të cilin është lëshuar vendim nr. Regj. Them. 1110 (31134-03679-80-2018), datë 14.06.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë "Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit",

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të neneve 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat";

### **URDHËROJ**

- 1 Vënien e sekuestros në aktivet e palës debitore **Shoqëria "TV-Blu" SHPK, me NIPT K83617801A.**
2. Vënien e sekuestros në kuotat ose aksionet që **Shoqëria "TV-Blu" SHPK, me NIPT K83617801A** mund të zotërojë në shoqëri të tjera, në cilësinë e ortakut ose aksionarit.
3. Për veprimet ose mosveprimet tuaja, na informoni me shkresë, brenda afatit ligjor.
4. Ndaj personave që do të pengojnë zbatimin e këtij titulli ekzekutiv në kundërshtim me parashikimet e ligjit, përbaruesi gjyqësor ka të drejtë të aplikojë sanksionet e parashikuara në nenet 598 dhe 606 të Kodit të Procedurës Civile si dhe të ndërmarrë çdo sanksion tjetër të parashikuar nga ligji.
5. Ky urdhër i njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile kanë të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni.

**Shoqëria "Tirana Execution Office" (TEO) SHPK  
Përbarues Gjyqësor Privat  
Fatjona Duka**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 58, DATË 19.03.2018

PËR KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË SË AUTORIZIMIT TË SHOQËRISË  
"TV-BLU" SH.P.K., PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT  
AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË RRJETIN KABLLOR "TV  
KABLLOR BLU"

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Piro	Misha	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar
Zylyftar	Bregu	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria "TV-BLU" sh.p.k.

Objekt: Konstatimi i pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë "TV-BLU" sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjetin kabllor "Tv Kabllor Blu"

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, neni 68, pika "b" i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 13, pika 1 i rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017

VËREN

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 429, datë 21.03.2006, ka licencuar subjektin person fizik, Mentor Gjuzi për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor "Tv Kabllor Blu". Në vijim, KKRT (sot AMA), me vendimin nr. 679, datë 18.02.2008, miratoi kalimin e pronësisë nga subjekti person fizik, Mentor Gjuzi tek shoqëria "TV-BLU" sh.p.k. për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor



"Tv Kabllor Blu". AMA, me vendimin nr. 23, datë. 27.12.2013, i ka zëvendësuar licencën e këtij subjekti me autorizim. Afati i vlefshmërisë së autorizimit përfundon në datën 04.04.2018.

Shoqëria "TV-BLU" sh.p.k., me shkresën nr. 687 prot., datë 08.02.2018, të depozituar pranë AMA-s, ka kërkuar të heqë dorë nga autorizimi i lëshuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjetin kabllor "Tv Kabllor Blu".

Konkretisht subjekti ka parashtruar se: "...Ju njoftojmë me shkrim se shoqëria po mbyll aktivitetin, ndaj kërkojmë të konsideroni të pavlefshëm, Autorizimin e Tv Blu për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve që nga data e këtij njoftimi...".

Nga verifikimi i faqes zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit të datës 27.02.2018 rezulton se:

- Shoqëria "TV-BLU" sh.p.k., është regjistruar si e tillë në datën 17.12.2008.
- NIPT-i i shoqërisë është K83617801A.
- Ortakë të shoqërisë janë: Besnik Murrizi me 50% të kuotave dhe Myslym Murrizi me 50% të kuotave.
- Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti është: "Radio-televizion kabllor".
- Zyra qendrore e ushtrimit të aktivitetit është në Kavajë, Rruga "Qemal Stafa", ndërtesë 5 katëshe, kati 1, me zonë kadastrale nr. 1791, nr. Pasurisë 97/23+ 2-2.
- Statusi i shoqërisë është: I pezulluar.

Nga verifikimi i kryer rezulton se, shoqëria "TV-BLU" sh.p.k., ka detyrime financiare të pashlyera ndaj AMA-s në masën 218,100 (dyqindetëmbëdhjetëmijënjëqind) lekë, nga të cilat 207.000 (dyqindeshtatëmijë) lekë, pagesë vjetore për autorizim për vitin 2018 dhe 11.100 (njëmbëdhjetëmijënjëqind) lekë, kamatëvonesë për vitin 2017. Afati për shlyerjen e detyrimit është data 31.03.2018.

Neni 68 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon se autorizimi bëhet i pavlefshëm kur :

*"b) i licencuari ose i autorizuari njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit;"*

Neni 13, pika 1 i rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, përcakton se aplikuesi i cili kërkon të heqë dorë nga autorizimi duhet të paraqesë pranë AMA: "a) Kërkesë me shkrim për heqje dore nga autorizimi..."

Për sa më sipër, AMA arrin në përfundimin se kërkesa e shoqërisë "TV- BLU" sh.p.k., për heqje dorë nga autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjetin kabllor "Tv Kabllor Blu", është e mbështetur në ligj,

## PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 68, pika "b" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

## VENDOSI:


1. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë "TV-BLU" sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjetin kabllor "Tv. Kabllor Blu", për shkak se subjekti nuk ka interes të ushtrorë aktivitetet në fushën audiovizive.
2. Subjekti, me njoftimin e këtij vendimi ka detyrimin ligjor të ndërpresë menjëherë transmetimin.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Piro	MISHA
	Suela	MUSTA
	Zylyftar	BREGU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË



Nr. regjistrimit themeltar 1110 (31134-03679-80-2018)

Data e regjistrimit 11.6.2018

Data e vendimit 14.6.2018

**V E N D I M**  
**“PËR LËSHIMIN E URDHËRIT TË EKZEKUTIMIT”**

Gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë, e përbërë nga:

**Gjyqtare: Elda VRIONI**

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Eralda Skënderasi**, në Tiranë, sot më datë 14.6.2018, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, kërkesën administrative nr.1110 akti, regjistruar më datë 11.6.2018, që i përket:

**KËRKUES:** **Autoriteti i Mediave Audiovizive**, me adresë në Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë.

**OBJEKTI:** Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit, për vendimin nr.58, datë 19.3.2018 në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare nga ana e shoqërisë “TV-BLU” shpk, me NUIS K83617801A, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Blu”, kundrejt AMA-s në masën prej 54,768 (pesëdhjetë e katërmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 511 i “Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;  
nenet 25, 26 dhe neni 132, pika 5 të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;  
ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;  
ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës dhe akteve që i bashkëngjiten asaj, gjykata pasi shqyrtoi provat e paraqitura nga pala kërkuese dhe konsultoi ligjin në lidhje me këtë kërkesë,

## V Ë R E N

Në bazë të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, - në të cilin janë përcaktuar tarifat dhe llojet e pagesave që subjektet ofrues të Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA), duhet të paguajnë në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë tregtare - , AMA ka kryer përlogaritjen e detyrimeve financiare edhe për subjektin "TV-BLU" shpk, dhe në vijim e ka njoftuar subjektin për shlyerjen e detyrimeve financiare me shkresën nr.248 prot., datë 16.1.2018, si dhe faturën nr. 90, datë 10.1.2018.

Më tej, AMA parashtron se me kërkesën e vetë subjektit, me vendimin nr.58, datë 19.3.2018, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë "TV BLU" shpk, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Blu". Pas marrjes se vendimit, AMA ka rillogaritur detyrimin financiar të subjektit për vitin 2018, referuar efekteve financiare dhe juridike, nga data 18.3.2018.

Me shkresën me nr.1535 prot. datë 4.4.2018, AMA ka njoftuar subjektin "TV BLU" shpk, se detyrimi i vitit 2018, për periudhën me vlefshmëri autorizimi (01 janar 2018 - 18 mars 2018) u reduktua në masën 43,668 lekë. Gjithashtu subjektit ju rikujtua se bashkë me detyrimin e rillogaritur për vitin 2018, detyrimi total i subjektit ndaj AMA-s është në masën **54,768 lekë** (11,100 leke kamatevonesa për vitin 2017 + 43,668 leke detyrime për autorizim të vitit 2018).

Pavarësisht dijenisë së subjektit nuk është përmbushur detyrimi dhe as është kundërshtuar gjyqësisht përmbajtja e këtyre akteve.

Neni 25, pika 4 e ligjit nr. 97/2013, rregullon mënyrën e caktimit të pagesave, sipas të cilit: *'Pagesa për marrjen e licencave ose autorizimit bëhet në momentin e marrjes së licencës ose autorizimit. Pagesat vjetore kryhen brenda tremujorit të parë të çdo viti kalendarik'*.

Neni 26 i ligjit të sipërcituar, përcakton se llojet e pagesave janë:

- a) pagesë për marrje licence dhe/ose autorizimi;
- b) pagesë vjetore për licencë dhe/ose autorizim;
- c) pagesë për perpunim aplikimi, dokumentacioni, ndryshime në licence dhe/ose autorizim.

Duke qenë se subjekti nuk e ka ekzekutuar vullnetarisht atë, AMA në mbështetje të nenit 132, pika 5 të ligjit nr.97/2012 "*Vendimet e AMA- s ekzekutohen nga shërbim përmbartimor sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile*" në cilësinë e kërkuarit, i është drejtuar gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, duke referuar edhe tek neni 3, pika 4 e ligjit nr.48/2014 "*Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*", ku përcaktohet shprehimisht se:... 4. "*Pagesë me vonesë*" është pagesa që nuk kryhet brenda afatit të përcaktuar me kontratë a me ligj, nga ana e sipërmarrjes tregtare dhe e autoritetit publik, kur janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji".

Në nenin 132, pika 5 të ligjit nr. 97/2013, percaktohet se: 'Vendimet e AMA-s, ekzekutohen nga shërbimi përbarimor, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përbarimor.

Sa me sipër dhe referuar nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i dytë germa "e" i të cilit, konsideron si të tillë edhe ato *akte që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për zbatimin e tyre, kërkesa duhet të pranohet.*

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të neneve 510, 511 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

### VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për vendimin nr.58, datë 19.3.2018 në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare nga ana e shoqërisë "TV-BLU" shpk kundrejt AMA-s, vetëm për masën prej 54,768 (pesëdhjetë e katërmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.
3. Urdhërimin e shërbimit përbarimor, për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
4. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
5. Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje.

-U shpall në Tiranë, sot me datë 14.6.2018

**SEKRETARE**  
**ERALDA SKENDERASI**

Shpenzime gjyqësore  
Tarifë kërkesë 0.00 lekë

